



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova – Kosovo Agency of Statistics

Draft Koncept Dokumenti për Regjistrimin e Popullsisë,

Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, 2021

Përgatitur nga: Zyra e Kryeministrit/ASK

Mars 2020,
Prishtinë

Përmbajtja

	Faqe
Lista e shkurtesave	3
Përmbledhje e koncept dokumentit	4
Hyrje	4
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit	9
1.1 Ligji aktual (2010)	10
1.2 Analiza e problemit	10
1.3 Shkaqet.....	11
1.4 Efektet	15
Kapitulli 2: Objektivat	18
Kapitulli 3: Opsionet	19
3.1: Opsioni asnjë ndryshim	19
3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore	19
3.3: Opsioni i tretë: Ndryshimi i Ligjit aktual për Regjistrimin e Popullsisë të Ekonomive Familjare dhe të Banesave nr.03/L-237	19
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme	21
4.1 Ndikimet ekonomike	22
4.2 Ndikimet shoqërore	22
4.3 Ndikimet mjedisore	23
4.4 Ndikimet në të drejtat themelore	24
4.5 Ndikimi gjinor	26
4.6 Ndikimet tek të rinjtë	27
4.7 Ndikimet në barazinë sociale	27
4.8 Ndikimi te NMV-të	28
4.10 Sfidat n hartimin e Koncept Dokumentit.....	28
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi	29
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve	30
6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme	30
6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet.....	35
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm	36
7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	36
<i>Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik</i>	37
<i>Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore</i>	39
<i>Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore</i>	42
<i>Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore</i>	44

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BQK	-	Banka Qendrore Kosovës
BPV	-	Bruto Produkti Vendor
BE	-	Bashkimi Evropian
BB	-	Banka Botërore
CAPI	-	Kompjuter Assisted Personal Interview
EUROSTAT	-	European statistics / European Commission
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GIS	-	Geographic information System
ILO	-	International Labour Organization
IPGJ	-	Indeksi i Pabarazisë Gjinore
IZHGJ	-	Indeksi i Zhvillimit Gjinor
KES	-	Komisionit Evropian për Statistika
NMV	-	Ndërmarrjet e Mesme dhe të Vogla
MF	-	Ministria e Financave
MSA	-	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OZHQ (SDG)	-	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
OKB	-	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PKZMSA	-	Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA- së
QR	-	Qarqet Regjistruese
SKZH	-	Strategjia Kombëtare për Zhvillim
SP- ZKM	-	Sekretari i Përgjithshëm - Zyra e Kryeministrit
UNDP	-	United Nations Development Programme
UNFPA	-	United Nations Population Fund
UNSD	-	Divizionit i Statistikave të Kombeve të Bashkuara (UNSD)
UNECE	-	United Nations Economic Commission for Europe
VNGJ	-	Vlerësimi i Ndikimit Gjinor

Përmbledhje e Koncept Dokumentit

Hyrje

Ndryshimet e mëdha demografike për një kohë të shkurtër, si në numër dhe strukturë kanë ndikim të theksuar në zhvillimet e ardhshme të popullsisë, si dhe në zhvillimet e tjera socio-ekonomike.

Publikimi i statistikave gjithëpërfshirëse, relevante, të sakta, në kohë, të qasshme, të interpretueshme dhe koherente, është një kusht absolutisht i domosdoshëm për vendimmarrje të rëndësishme dhe efektive në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në të gjitha sferat e tjera të jetës shoqërore dhe ekonomike. Vendimmarrja, e bazuar në fakte dhe në të dhëna të përditësuara, është një model i njohur në mënyrë universale. Prodhimi i statistikave të detajuara për zonat e vogla dhe grupet e vogla të popullsisë është themeli i saj. Këto shifra dhe fakte mund të prodhohen vetëm përmes Regjistrimit të përgjithshëm të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave.

Sipas Rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara “Regjistrimi i Popullsisë është proces i përgjithshëm i planifikimit, mbledhjes, përpunimit, vlerësimit, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave mbi demografinë ekonomike dhe sociale në nivele më të vogla gjeografike, në një kohë të caktuar, të të gjithë personave në një shtet (vend), ose në një pjesë të kufizuar të shtetit”.

Sipas të njëjtit burim, “Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave është proces i përgjithshëm i planifikimit, mbledhjes, përpilimit, vlerësimit, shpërndarjes dhe analizimit të të dhënave statistikore, lidhur me numrin dhe gjendjen e banimit, njësitë dhe objektet në dispozicion, që familjet kanë, në një kohë të caktuar, të të gjithë banorëve të një vendi ose një pjese të kufizuar të territorit (vendit)”¹.

Karakteristikat thelbësore të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave janë: numërimi individual, gjithë përfshirja brenda një territori të përcaktuar, njëkohshmëria, bërja periodike, si dhe rregullimi normativ i tij (nxjerrja e Ligjit të veçantë për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave) në një pjesë të konsiderueshme të vendeve, siç ndodhë edhe në Kosovë.

Të dhënat e gjeneruara nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave kanë përdorim të gjerë dhe shfrytëzues të shumtë.

Qëllimi themelor i Regjistrimit të Popullsisë është që:

- të sigurojë fakte thelbësore për politikë bërje, planifikim dhe administrim në nivel kombëtar dhe në nivel lokal;
- të sigurojë të dhëna të domosdoshme për analiza shkencore dhe vlerësim të përbërjes, shpërndarjes dhe rritjes së popullsisë në të ardhmen;

¹ United Nations, Department of Economic and Social Affairs Statistics Division (2017), *Principles and Recommendations for Population and Housing Censuses Revision 3*, pg. 2

- një numër i saktë i popullsisë është thelbësor për llogaritjen e njërit prej treguesve më të rëndësishëm për matjen e zhvillimit ekonomik, siç është Bruto Produkti Vendor (BPV) për kokë banori, përmes të cilit monitorohet zhvillimi ekonomik i vendit dhe shpesh përdoret drejtpërsëdrejti për krahasime ndërkombëtare të performancës ekonomike;
- një BPV për kokë banori, e besueshme, ka rëndësi të madhe për përpilimin dhe llogaritjen e treguesve të tjerë, si: Indeksi i Zhvillimit Njerëzor, Indeksi i Varfërisë Multidimensionale, Indeksi i Zhvillimit Gjinator, Shkalla e Punësimit etj., si pjesë e diskutimit kombëtar dhe ndërkombëtar për matjen e mirëqenies dhe zhvillimit njerëzor;
- të dhënat kanë shumë përdorime të rëndësishme për individët dhe institucionet në biznes, industri dhe në punë;
- Regjistrimi i Popullsisë përbën burimin kryesor të të dhënave për krijimin e Kornizës së mostrave që mundëson zgjedhjen e mostrave probabilitet dhe realizimin e anketave për hulumtime të çështjeve të rëndësishme, si: hulumtimi i fuqisë punëtore, hulumtimi i standardit jetësor, hulumtimi i migracionit etj., që mundësojnë në vazhdimësi të nxirren tregues të rëndësishëm;
- të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë i ndihmojnë agjencitë ndërkombëtare dhe qeveritë në dhënie e ndihmave dhe asistencës tjetër për vendin; i ndihmojnë investitorët ndërkombëtarë në marrjen e vendimeve për investime;
- ndryshimet në të dhënat e popullsisë do t'i ndryshojnë flukset financiare të sistemit të të ardhurave dhe do të përdoren si një referencë kritike për ta siguruar barazinë në shpërndarjen e pasurisë, shërbimeve qeveritare dhe përfaqësimit në mbarë vendin, duke informuar shpërndarjen dhe alokimin e fondeve qeveritare ndërmjet rajoneve dhe rretheve të ndryshme për arsim, shërbimeve shëndetësore, përcaktimin e rretheve zgjedhore në nivel kombëtar dhe lokal.
- rezultatet e Regjistrimit të Ndërtesave dhe Banimit janë të lidhura me variabla të tjerë të Regjistrimit të Personave dhe Familjeve, kështu që komunat janë në gjendje të hartojnë parashikime solide të kërkesës për strehim - bazuar në strukturën specifike demografike të secilës komunë.
- Pra, rezultatet e Regjistrimit të Ndërtesave dhe Banimit ofrojnë të dy informacionet e rëndësishme për monitorimin e tregut, shumë të veçantë, dhe një bazë të përditësuar për monitorimin urban të zonave të vogla.

Regjistrimi i fundit i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë është realizuar në prill të vitit 2011 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), në bashkëpunim me Komisionet Komunale të Regjistrimit (KKR), që ishin krijuar nëpër komunat e Kosovës nën mbikëqyrjen e Komisionit Qendror të Regjistrimit.

Regjistrimi është bazuar në *Ligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave*, Nr. 03/L-237, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, në tetor të vitit 2010. Ky Ligj ishte i bazuar në Rekomandimet e Komisionit Evropian për Statistika (KES) për rundin e regjistrimeve të vitit 2010 dhe në Rregulloren e Këshilli Evropian, Nr. 763/2008 për Regjistrimin e Popullsisë dhe Ekonomive Familjare, të miratuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian, më 9 korrik 2008.

Meqenëse kanë kaluar gati 10 vjet nga Regjistrimi i fundit i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, të dhënat për treguesit kryesorë socio-ekonomikë janë vjetruar dhe duhet të përditësohen me Regjistrim të ri. Përsëritja e Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave pas periudhës 10 vjeçare është edhe rekomandim ndërkombëtar.

Ligji aktual për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (2010) nuk përfshin rekomandimet e fundit ndërkombëtare për Regjistrimin e Popullsisë (UNECE² - Eurostat) dhe nuk është i përshatshëm me nevojën specifike të vendit tonë për hartimin e Regjistrimit të Popullsisë.

Gjithashtu, edhe struktura e Ligjit aktual nuk është në harmoni me metodologjinë, që do të aplikohet në Regjistrimin e Popullsisë 2021 (metoda CAPI).

Për faktin se Ligji aktual ka të specifikuar kohën dhe afatin e Regjistrimit, gjegjësisht momentin kritik të Regjistrimit të Popullsisë (ora 24:00, ndërmjet 31 marsit dhe 01 prillit 2011) dhe datën e fillimit dhe të përfundimit të mbledhjes së të dhënave në terren (1-15 prill, 2011) e që në vitin 2021 planifikohet të jetë ora 24:00, ndërmjet 31 marsit dhe 01 prillit 2021 deri me 30 Prill 2021 që e bën atë të pazbatueshëm për Regjistrimin e Popullsisë në vitin 2021.

Koncept Dokumenti për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2021 do ta përfshijë një përshkrim të hollësishëm të politikës dhe kornizës ligjore ekzistuese, të institucioneve shtetërore përgjegjëse për zbatim, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre në procesin e përgatitjes dhe realizimit të Regjistrimit të Popullsisë në Kosovës në vitin 2021. Ky Koncept Dokument adreson çështjet relevante, që janë të lidhura me procesin e Regjistrimit të Popullsisë.

Tabela e mëposhtme jep të dhënat e përgjithshme, ndikimet e pritshme si dhe hapat e ardhshëm afatshkurtër dhe afatmesëm.

Tabela 1: Informacionet e përgjithshme

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept dokumenti për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, 2021
Ministria/Institucioni bartës	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Personi kontaktues	Avni Kastrati: tel: +383 38 200 105, email: avni.kastrati@rks-gov.net
PVPQ	ZKM, Tabela B Objektivi 26, aktiviteti 26.7, treguesi 1, Plani vjetor i punës së Qeverisë. Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2019, nënshkruar nga SP- ZKM.
Prioriteti strategjik	Plani strategjik i Agjencisë së Statistikave të Kosovës (2018-2022), MSA, Neni 95, PKZMSA, Kapitulli 18 Programi i Qeverisë 2017-2021
Vendimi	
Çështja kryesore	
Përmbledhje e konsultimeve	Grupi punues për Koncept dokumentin në përbërje të tije ka përfaqësueses të institucioneve publike, universiteti dhe institucionet

² The United Nations Economic Commission for Europe (UNECE)

	ndërkombëtare gjatë hartimit të këtij dokumenti sugjerimet e tyre janë inkorporuar në dokument. Koncept Dokumenti ka kaluar të gjitha procedurat e konsultimit paraprak ndërministror sipas nenit 7 të RPQ, Platforma online për Konsultime publike sipas nenit 32,shyrtimi i komenteve të grupit punues.
Opsioni i propozuar	Opsioni i tretë: Plotësim ndryshimi i Ligji nr. 03/l-237 për: Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave.
Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	11,445,591 € (10,000,000 nga Buxheti i RKS dhe rreth 1,500,000-priten nga donatorët).
Ndikimet ekonomike	Ofrimin e të dhënave për vendimmarrësit, planifikime adekuate dhe me kosto reale bazuar në të dhënat e disponueshme.
Ndikimet shoqërore	Ofrimi i një pasqyre të qartë të strukturës së popullsisë dhe çështjeve tjera socio-ekonomike.
Ndikimet mjedisore	Dendësia e objekteve të banimit, popullsisë dhe infrastrukturës mundëson bërjen e analizave dhe planeve detale.
Ndikimet ndër-sektoriale	Çdo e dhënë për popullsinë; strukturën, punësimin, edukimin dhe kushtet e jetesës është e ndërlidhur me sektorë përkatës.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Nuk është aplikuar.
Testi i NVM-ve	Nuk është aplikuar. Regjistrimi i Popullsisë kryhet në ekonomi familjare dhe banesa, andaj nuk ka të bëjë me NVM.

Hapat e ardhshëm	
Amendamenti i ligjit aktual	Ligji aktual (2010) mbi Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave duhet të amendamentohet.
Afatshkurtër	Realizimi i pilot projektit, blerja e pajisjeve, hapja e fushatës komunikuese, hapja e konkurseve, trajnimet etj.
Afatmesëm	Realizimi i Regjistrimit të Popullsisë në terren (2021), përpunimi, analizimi dhe shpërndarja e rezultateve finale (2021-2024).

Të dhënat në tabelën e mëposhtëm pasqyrojnë titullin e dokumentit, ndër lidhshmërinë me planet e Qeverisë së Kosovës, prioritetet, përbërjen e grupit punues si dhe informatat shtesë.

Tabela 2: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept dokumenti për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave
Ministria/Institucioni bartës	Agjencia e Statistikave të Kosovës
Personi kontaktues	Avni Kastrati: tel: +383 38 200 105, email: avni.kastrati@rks-gov.net
Plani Vjetor i Punës së Qeverisë (PVPQ)	Zyra e Kryeministrit (ZKM), Tabela B: Objektivi 26, Aktiviteti 26.7, treguesi 1, Plani Vjetor i Punës së Qeverisë 2019/2020. Lista e Koncept Dokumenteve për vitin 2019/2020, nënshkruar nga SP-ZKM
Prioriteti strategjik	Programi i Statistikave Zyrtare, 2018-2022 Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA), Neni 95 Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA- së (PKZMSA), Kapitulli 18

	Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021 (Të shihet objektivi).
Grupi punues	Agjencia e Statistikave të Kosovës; Zyra ligjore, ZKM; Zyra për Planifikim Strategjik, ZKM; Zyra e Sekretariatit për Koordinim Qeveritar, ZKM; Ministria e Financave; Ministria e Integritetit Evropian; Qendra për Studime Gjinore; Universiteti i Prishtinës; UNFPA
Informata shpeshë	Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë është shumë i rëndësishëm të realizohet në kohë dhe të jetë i krahasueshëm me standardet ndërkombëtare duke u bazuar në Rekomandimet e Komisionit Evropian për Statistika (KES).

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave ofron një pasqyrë të saktë, të detajuar dhe me shtrije gjeografike për çështjet socio-ekonomike të vendit, duke ofruar një gamë shumë të gjerë të të dhënave në një kohë të vetme. Këto të dhëna janë shumë të vlefshme për planifikime, strategji dhe analiza të ndryshme. Përveç nevojave kombëtare, regjistrimet janë të rëndësishme edhe për krahasime ndërkombëtare, si dhe për t'i vlerësuar dhe për t'i parashikuar trendët e zhvillimit në të ardhmen. Sipas rekomandimit ndërkombëtar³ që shtetet ta zhvillojnë Regjistrimin e Popullsisë së paku brenda një dekade (zakonisht në fund të çdo dekade).

Prandaj, Kosova planifikon ta realizojë Regjistrimin e Popullsisë, duke u bërë pjesë e rëndësishme të regjistrimeve, përfshirë synimet e *Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)*, si dhe zbatimin e Acquis-it të BE-së. Bazuar në zhvillimet teknologjike, grumbullimi i të dhënave nga terreni do të bëhet përmes metodës IPAK (Intervista Personale e Asistuar me Kompjuter) e njohur në gjuhën angleze si metoda CAPI (Kompjuter Assisted Personal Interview).

Tabela 3: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën ose dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni (-et) shtetëror (e) përgjegjës (e) për zbatim	Roli dhe detyrat e institucionit (-eve)
Ligji për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës (2011)	ASK; ZKM; http://ask.rks-gov.net/media/2023/ligji-per-statistikat-zyrtare-te-republikes-se-kosoves.pdf	ASK, BQK, MF	Mbledhja, përpunimi, analizimi dhe shpërndarja e të dhënave zyrtare statistikore
Ligji për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare DHE Banesave (2010)	ASK; ZKM; http://ask.rks-gov.net/media/1858/ligji-p%C3%AB-regjistrimin-e-popullsis%C3%AB-ekonomive-familjare-dhe-banesave.pdf	ASK, Institucionet e tjera Qeveritare dhe Komunitat	Regjistrimi i Popullsisë 2011
Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit (MSA)	ZKM; http://kryeministri-ks.net/repository/docs/Kosovo-EU_SAA_Final_1.pdf (NENI 95)	Qeveria, ASK, BQK, MF	Zbatimi i rekomandimeve të dalës nga MSA
Programi i Statistikave Zyrtare 2018-2022	ASK; http://ask.rks-gov.net/media/3774/programi-strategjik-05012018.pdf	ASK, institucionet e tjera Qeveritare dhe Komunitat	Zbatimi i prioriteteve strategjike
Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021	https://www.min-rks.net/repository/docs/programi_i_qeverise_se_republikes_se_kosoves_2017_2021	ZKM ASK	Zbatimi i objektivave
Programi për Reforma në Ekonomi 2019-2021	https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/85F252D8-FEAE-46BF-8CBD-F110BBA0B8EE.pdf	Qeveria, MF, ASK	Zbatimi i masave socio-ekonomike:

³ Konferenca Evropiane e Statisticienëve: Rekomandimet për Regjistrimin e Popullsisë dhe Ekonomive Familjare 2020

1.1 Ligji aktual (2010)

Ligji aktual (2010) nuk përfshin rekomandimet e fundit ndërkombëtare (UNECE-Eurostat), nuk është i përshtatshëm me nevojën specifike të vendit për hartimin e Regjistrimit të Popullsisë. Struktura organizative të Ligji paraprak (2010) nuk është në harmoni me metodologjinë, që do të aplikohet në Regjistrimin e Popullsisë 2021 (metoda CAPI). Po ashtu, Ligji aktual ka të specifikuar datën (afatin) e realizimit të Regjistrimit, që nuk përkon me Regjistrimin e Popullsisë 2021. Regjistrimi i popullsisë 2021 do të jetë bazë për krijimin e Regjistrimit të Popullsisë ku në të ardhmen Regjistrimi pritet të bazohet në të dhënat administrative.

Tabela 4: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Pamundësia e publikimit të të dhënave në nivele më të vogla se 1 km ² , duke filluar nga vendbanimet.
	Pamundësia për hartimin e Regjistrimit të Popullsisë dhe regjistrave të tjerë.
	Mos regjistrimi i popullsisë pamundëson sigurimin e cilësisë, saktësisë së të dhënave dhe rritjen e kostos financiare duke u bazuar në statistika jo të freskëta/jo reprezentative.
Problemi kryesor	Të dhënat e vjetruara nga Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2011 pamundëson përmirësimin e vendimmarrjes në bazë të të dhënave të sakta, me kohën në të cilën funksionon shoqëria.
Shkaqet	Ligji aktual (2010) nuk përfshin rekomandimet e fundit ndërkombëtare (UNECE-Eurostat).
	Ligji i viti 2010 nuk është i përshtatshëm me nevojën specifike të vendit tonë për hartimin e Regjistrimit të Popullsisë
	Metodat e Regjistrimit të Popullsisë nga viti 2010 janë të vjetruara. Në Regjistrimin e Popullsisë 2021 do të përdoret metodologjia e re për grumbullimin e të dhënave (CAPI)
	Ligji i vitit 2010 e ka të specifikuar datën (afatin) e realizimit të Regjistrimit të Popullsisë, që e pamundëson Regjistrimin e Popullsisë 2021

1.2 Analiza e problemit

Të dhënat e vjetruara për treguesit socio-ekonomikë të Regjistrimit të fundit të Popullsisë 2011.

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave i fundit është kryer në vitin 2011, ku të dhënat e nxjerra nga ky Regjistrim janë të vjetruara. Ka mungesë të të dhënave të detajuara për popullsinë në nivel lokal (Vendbanim, Komunë). Gjithashtu, Korniza e mostrave për dizajnimin e mostrave për anketat e ndryshme socio ekonomike në ASK është e vjetërsuar. Është standard ndërkombëtar dhe rekomandim i BE-së, që Regjistrimet e Popullsisë të realizohen së paku çdo 10 vjet. Duke marrë parasysh se Kosova Regjistrimin e fundit të Popullsisë e ka realizuar në vitin 2011, propozohet që Regjistrimi i ardhshëm i Popullsisë të realizohet në muajin prill 2021, që Kosova të jetë pjesë e rëndësive të ardhshme të regjistrimeve në nivel ndërkombëtar. Regjistrimi i Popullsisë 2021 ka edhe një rëndësi shtesë për Kosovën, duke marrë në konsideratë që në Regjistrimin e fundit të Popullsisë të vitit 2011 një pjesë e komuniteti serb (4 komuna) nuk kanë marrë pjesë në Regjistrim. Regjistrimi i Popullsisë i vitit 2021 pritet të jetë gjithëpërfshirës, bazuar në interesin e përgjithshëm të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

1.3 Shkaqet

Ligji aktual (2010) nuk përfshin rekomandimet e fundit ndërkombëtare (UNECE-Eurostat).

Rekomandimet e fundit⁴ sugjerojnë që pjesë e Regjistrimit të Popullsisë të jenë disa pyetje shtesë për: popullsinë rezidente, migracionin, aftësitë e kufizuara dhe për ekonomitë familjare, që nuk ishin të përfshira në vitin e aplikuar, 2011. Po ashtu, numri i dërgimit të të dhënave në Eurostat është rritur dhe të dhënat duhet të dërgohen në afatin e propozuar në Rregulloren e EU-së për Regjistrimin e Popullsisë 2020.

Sa i përket **legjislacionit të BE-së**, duke u bazuar në kapitullin e 18-të të Acquis-së Statistikat ku përgjegjësitë kryesore janë ofrimi i informacionit statistikor. Acquis në fushën e statistikave kërkon ekzistencën e një infrastrukture statistikore bazuar në parime të tilla si paanshmëria, besueshmëria, transparenca, konfidencialiteti i të dhënave individuale dhe shpërndarja e statistikave zyrtare. Acquis në fushën e statistikave përbëhet pothuajse ekskluzivisht nga legjislacioni (Rregulloret e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, dhe Vendimet dhe rregulloret e Komisionit) që është i zbatueshëm drejtpërdrejt për shtetet anëtare të BE-së. Acquis statistikor përmban gjithashtu një gamë të gjerë manualesh dhe metodologji në fusha të ndryshme statistikore si bujqësia, politika ekonomike dhe monetare, statistikat demografike, sociale dhe hulumtimet. Asnjë transpozim në legjislacionin kombëtar nuk është i nevojshëm pasi shumica e Acquis merr formën e rregulloreve pas anëtarësimit në BE.

Sa i përket statistikave⁵, neni 95 të MSA “Bashkëpunimit Statistikor” definon përgjegjësitë e Agjencionit të Statistikave të Kosovës dhe ofron kornizën që bashkëpunim midis Palëve të përqendrohet kryesisht në fushat që kanë prioritet që lidhen me Acquis të BE-së në fushën e statistikave. Ky nen, gjithashtu nënvizon që, sistemi statistikor duhet të jetë në përputhje me parimet e Kodit Statistikor Evropian të Praktikës dhe parimeve themelore të statistikave nga OKB, citatet e drejtës Statistikore Evropiane, dhe duhet të zhvillohet në drejtim të zbatimit të Acquis-it të BE-së në fushën e statistikave.

Agjencioni Statistikor i Kosovës në Planin e Veprimit për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), në bllokun tre: “Standardet Evropiane – Përafrimi i Legjislacionit të Kosovës me Acquis të BE-së në kapitullin 18 - Statistikat” ka listuar një numër masash afatshkurtër dhe afatmesme të cilat duhet të realizohen në periudhën e paraparë në marrëveshjen e MSA-së.

Bashkëpunimi i gjatë midis agjencive ndërkombëtare dhe mbarëkombëtare, përkatësisht Divizionit i Statistikave të Kombeve të Bashkuara (UNSD), Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) dhe Komisionit Evropian (Eurostat), ka çuar në harmonizimin e përkufizimeve dhe specifikimeve teknike që shtrihen përtej BE-së tek anëtarët e tjerë të UNECE-së apo edhe në nivel botëror (UNSD). Prandaj gjatë përgatitjes së Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2021 duhet të konsultohen dhe të ketë harmonizim edhe me dokumentet si në vijim:

- Legjislacioni i BE-së për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave 2021 (shënime sqaruese).⁶
- Konferenca e Statistikave Evropiane - Rekomandime për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave të vitit 2020.⁷
- Parimet dhe Rekomandimet për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave.⁸

⁴ https://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/publications/2015/ECECES41_EN.pdf

Conference of European Statisticians Recommendations for the 2020 Censuses of Population and Housing

⁵ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_55-te_te_Qeverise_se_Republikes_se_Kosoves_2015.pdf;

Vendimi i Qeverise se Kosovës Nr. 02/55 i datës 30.10.2015 mbi ratifikimin e Marrëveshjes se Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian

⁶ <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/9670557/KS-GQ-18-010-EN-N.pdf/c3df7fcb-f134-4398-94c8-4be0b7ec0494>

⁷ https://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/publications/2015/ECECES41_EN.pdf

⁸ https://unstats.un.org/unsd/publication/seriesM/Series_M67Rev3en.pdf

Më poshtë listohet legjislacioni relevant në proces të përafrimit të legjislacionit vendor me atë të BE-së për Regjistrimin e Popullsisë.

Tabela 5 – Lista e akteve më të rëndësishme të acquis nga fusha e Statistikave – regjistrimi i popullsisë dhe niveli i transpozimit

Emërtimi i aktit normativ të BE-së	Përmbajta dhe qëllimi	Legjislacioni vendor që transponon Acquis të BE-së dhe niveli i përputhshmërisë
Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane e miratuar më 16 nëntor 2017, për Autoritetet e Statistikave Kombëtare dhe Eurostat ⁹	Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane është gur themeli i kornizës të përbashkët për cilësi e sistemit Evropian Statistikor. Është një instrument vetë-rregullues dhe bazohet në 16 Parime që mbulojnë mjedisin institucional, proceset statistikore dhe rezultatet statistikore. Një grup treguesish të praktikave dhe standardeve më të mira për secilin nga Parimet siguron udhëzime dhe referencë për zbatimin e Kodit të Praktikës, duke rritur transparencën brenda Sistemit Evropian Statistikor.	Ligji Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058. Pjesërisht e transpozuar.
Korniza e Sigurimit të Cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave. ¹⁰	Kjo kornizë identifikon aktivitetet, metodat dhe mjetet e mundshme që mund të sigurojnë udhëzime dhe prova për zbatimin e treguesve, d.m.th. lehtëson marrjen e hapave të nevojshëm për operacionalizimin e treguesve që kërkohen në secilin parim të Kodit të Praktikës Statistikore.	Ligji Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058. Pjesërisht e transpozuar.
Rregullorja (KE) Nr. 763/2008 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 9 Korrik 2008, për regjistrimin e popullsisë dhe banesave. ¹¹	Kjo rregullore përcakton rregulla të përbashkëta për sigurimin e të dhënave gjithëpërfshirëse për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave.	Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave. Pjesërisht e transpozuar.

⁹ Kodi i Praktikës së Statistikave Evropiane: <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/4031688/8971242/KS-02-18-142-EN-N.pdf/e7f85f07-91db-4312-8118-f729c75878c7>

¹⁰ Korniza e Sigurimit të Cilësisë së Sistemit Evropian të Statistikave: https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/5923349/QAF_2012-EN.PDF/fcdf3c44-8ab8-41b8-9fd0-91bd1299e3ef?version=1.0

¹¹ Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit (KE) Nr. 763/2008 për regjistrimet e popullsisë dhe banesave: <https://eur-ex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=OJ:L:2008:218:0014:0020:EN:PDF>

<p>Rregullore (KE) Nr. 223/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 11 mars 2009. për statistikat evropiane dhe shfuqizimin e Rregullores (KE, Eurostat) Nr. 1101/2008 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për transmetimin e të dhënave që janë subjekt i konfidencialitetin statistikor për Zyrën e Statistikave të Komuniteteve Evropiane, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 322/97 mbi Statistikat e Komunitetit dhe Vendimin e Këshillit 89/382 / EEK, Eurostat për krijimin e një Komiteti për Programet Statistike të Komuniteteve Evropiane.</p>	<p>Kjo rregullore krijon një kornizë ligjore për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave evropiane.</p>	<p>Ligji Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058.</p> <p>Pjesërisht e transpozuar.</p>
<p>Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2017/543, e datës 22 Mars 2017, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 763/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave, në lidhje me specifikat teknike dhe zbërthimin e temave.¹²</p>	<p>Kjo rregullore ka për qëllim për të siguruar që të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave të bëra në shtetet anëtare janë të krahasueshme, dh lejojnë ofrimin e një pasqyre të besueshme në mbarë BE-në, temat e regjistrimit duhet të krijohen dhe të ndahen në të njëjtën mënyrë në të gjitha Shtetet Anëtare. Prandaj duhen miratuar specifikat teknike për ato tema dhe zbërthimin e tyre.</p>	<p>Ligji Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave.</p> <p>Pjesërisht e transpozuar.</p>
<p>Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/712 e datës 20 Prill 2017, që përcakton vitin referues dhe programin e të dhënave statistikore dhe metadata për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave siç parashihet me Rregulloren (KE) Nr. 763/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.¹³</p>	<p>Kjo rregullore përcakton programin e të dhënave statistikore dhe metadata për Regjistrimin e Popullsisë dhe Banesave që do t'i transmetohen Komisionit (Eurostat-it) për vitin referues 2021.</p>	<p>Ligji Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-058.</p> <p>Pjesërisht e transpozuar.</p>
<p>Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2017/881, e datës 23 Maj 2017, për zbatimin e Rregullores (KE) Nr. 763/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për regjistrimin e popullsisë dhe banesave, sa i përket modaliteteve dhe strukturës së raporteve të cilësisë dhe formatit teknik për transmetimin e të dhënave, duke plotësuar rregulloren (BE) Nr. 1151/2010.¹⁴</p>	<p>Kjo rregullore përcakton modalitetet dhe strukturën e raporteve të Shteteve Anëtare mbi cilësinë e të dhënave që transmetohen në Komision (Eurostat) nga Regjistrimi i Popullsisë dhe Banesave për vitin referues 2021, dhe formatin teknik për transmetimin e të dhënave.</p>	<p>Ligji Nr. 04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-058.</p> <p>Pjesërisht e transpozuar.</p> <p>...</p>

¹² Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2017/543: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017R0543&qid=1584091385110&from=EN>

¹³ Rregullorja e Komisionit (BE) 2017/712: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017R0712&from=EN>

¹⁴ Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2017/881: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32017R0881&qid=1584103638475&from=EN>

<p>Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2018/1799, e datës 21 nëntor 2018, për krijimin e një veprimi të përkohshëm të drejtpërdrejtë statistikor për shpërndarjen e temave të zgjedhura të Regjistrimit të Popullsisë dhe Regjistrimit të Banesave 2021, gjeokoduar në një rrjet 1 km².¹⁵ Baza ligjore për një "veprim të përkohshëm të drejtpërdrejtë statistikor" të përmendur në titull rrjedh nga neni 14 (2) i Rregullores kornizë (KE) Nr. 223/2009 (7) e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi statistikat Evropiane.</p>	<p>Me këtë rregullore përcaktohet një veprim i përkohshëm statistikor i përkohshëm për të zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë temat e zgjedhura të Regjistrimit të Popullsisë dhe Regjistrimit të Banesave 2021, në një rrjet prej 1 km² ('1 km² grid data').</p> <p>Për këtë qëllim, përcaktohet një rrjet unik i harmonizuar dhe i vazhdueshëm gjeo-hapësinor për Evropën, i cili përbëhet nga pjesë me një sipërfaqe prej 1 km². Ku janë përcaktuar temat specifike dhe zbërthimet e tyre, si dhe programi i detajuar dhe metadata për shpërndarjen e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2021 të gjeokoduara në rrjetin e referencës 1 km².</p>	<p>Do të jete pjese e ligjit te amendamentuar.</p>
<p>Konferenca Evropiane e Staticienteve Rekomandimet për Regjistrimin e Popullsisë, 2020</p>	<p>Me këtë rekomandim iu sugjerohet vendeve që të inkorporojnë pyetjet kryesore dhe jo kryesore me qëllim të krahasimit ndërkombëtar. Po ashtu sugjerohet që të bëhet e qartë definimi i metodologjisë mbi popullsinë rezidente dhe jo-rezidente.</p>	<p>E transpozuar në ligjin aktual (2010) dhe do të jetë pjesë në ligjin i cili do të amendamentohet.</p>

Ligji aktual nuk është i përshtatshëm me nevojën specifike të vendit tonë për hartimin e Regjistrimit të Popullsisë.

Në Ligjin aktual (2010), Neni 8, i këtij ligji nuk e përfshin grumbullimin e të dhënave për numrin personal dhe adresat e sakta, që mundësojnë krijimin e Regjistrimit të Popullsisë, që është i domosdoshëm për nevojat e vendit, për prodhimin e statistikave. Mungesa e numrit personal pamundëson lidhjen me bazat e të dhënave të regjistrave administrativë, që gjenden në institucionet qendrore dhe lokale të Republikës së Kosovës.

Struktura paraprake e Ligjit (2010) nuk është në harmoni me metodologjinë, që do të aplikohet në Regjistrimin e ardhshëm të Popullsisë (metoda CAPI).

Metoda e Regjistrimit të Popullsisë, sipas Ligjit aktual (2010) ishte tradicionale, derë më derë, përmes pyetësorëve të Regjistrimit të Popullsisë. Ndërsa, duke i ndjekur trendët e kryerjes së Regjistrimit të Popullsisë në BE dhe Rajon, Regjistrimi i Popullsisë 2021 planifikohet të kryhet me metodën (CAPI- "Computer Assisted Personal Interviewing"), që do të thotë kryerja e Regjistrimit përmes kompjuterit ose tabletëve. Metoda CAPI është më e efikase dhe mundëson grumbullimin më të shpejtë dhe më cilësorë të të dhënave; mundëson kontrollimin dhe monitorimin më të mirë të fazës së grumbullimit të të dhënave gjatë Regjistrimit; si dhe shkurton kohën e publikimit të rezultateve.

¹⁵ Rregullorja zbatuese e Komisionit (BE) 2018/1799: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32018R1799&qid=1584107637091&from=EN>

Ligji aktual (2010) e ka të specifikuar datën (afatin) e realizimit të Regjistrimit të Popullsisë, që nuk përkon me Regjistrimin e Popullsisë 2021.

Koha dhe afati i Regjistrimit të Popullsisë sipas Ligjit aktual (2010) është ora 24:00 ndërmjet 31 marsit dhe 01 prillit 2011. Regjistrimi i Popullsisë në Kosovë zbatohet nga data 01-15 prill 2011 dhe kjo e kufizon dhe e pamundëson kryerjen e Regjistrimit të Popullsisë 2021 që planifikohet të bëhet nga data 01-30 Prill 2021. Gjithashtu, Ligji aktual (2010) e kufizon ose e pamundëson kryerjen e Anketës së Pas-Regjistrimit pasi (APR) e ka të cekur datën, ku thotë: Pas përfundimit të Regjistrimit, në periudhën prej 16-22 prill 2011 duhet të realizohet Anketa e Pas-Regjistrimit, e cila bazohet në një mostër reprezentative të Qarqeve Regjistruese deri në 0.5% të Popullsisë, në mënyrë që të vlerësohen rezultatet dhe mbulueshmëria e Regjistrimit të Popullsisë, si dhe cilësia e të dhënave të mbledhura në regjistrim.

1.4 Efektet

Pamundësia e publikimi të të dhënave në nivele më të vogla se 1km², duke filluar nga vendbanimet.

Nëse nuk realizohet Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2021 nuk do të ketë të dhëna të detajuara dhe të plota në nivel Vendbanimi, Komune dhe Rajoni. Po ashtu, nuk do të ketë të dhëna për dendësinë e Popullsisë për 1km² që i kërkon Eurostatit. Pa Regjistrimin e Popullsisë 2021 nuk do të jetë e mundur prodhimi i treguesve të SDG-së, si dhe nuk do të mund të bëhet vlerësimi i Popullsisë sipas viteve në seri kohore për shkak të lëvizjeve të shumta të popullsisë brenda dhe jashtë Kosovës.

Mos Regjistrimi i Popullsisë pamundëson sigurimin e cilësisë, saktësisë së të dhënave dhe rritje të kostos financiare për hulumtime.

Nëse nuk realizohet Regjistrimi i Popullsisë Ekonomive Familjare dhe Banesave, 2021 nuk do të ketë të dhëna të freskëta e të detajuara të cilat do të mundësonin planifikime të drejta strategjike afat shkurtër, afatmesme dhe afatgjata për Institucionet qendrore dhe lokale, bizneset etj. Nëse nuk realizohet Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, 2021 rritet kostoja e prodhimit të statistikave përmes anketave të cilat në krahasim me Regjistrimin do të jenë jo të plota dhe kostoja do të jetë dyfishi i koston së Regjistrimit të Popullsisë.

Në figurën 4, mund të shihni identifikimin e palëve të interesuara që janë të lidhura me shkaqet e identifikuar dhe efektet. Një mënyrë praktike për të paraqitur përfshirjen e palëve të interesuara është paraqitur në përmbledhjen e mëposhtme. Palët e interesuara të ndikuara nga problemi janë Institucionet Qendrore, Komunitat, Akademia, Universitetet, Ndërmarrjet Publike, Organizatat Jo-Qeveritare, Media, Hulumtuesit si dhe Institucionet Ndërkombëtare si Eurostat, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore. Të gjitha palët janë të lidhura me shkakun 1, 2, 3, 4 dhe efektet 1, 2, 3, mënyra me të cilën pala është e lidhur me shkaqet dhe efektet është e drejtpërdrejt.

Të dhënat mbi popullsinë dhe çështjet tjera sociale kanë një rëndësi të madhe që të jenë në dispozicion për **Institucionet Qendrore (Ministritë, Agjencitë, etj.)**, pasi që në këtë mënyrë ofrohet mundësia për ndërmarrjen e masave mbështetëse, planifikim të politikave, hartim të ligjeve, hartim të strategjive dhe analiza të ndryshme. Numri i indikatorëve të shumët në nivel Vendbanimi/Komune është shumë i rëndësishëm për **Komuna**, pasi që në këtë mënyrë ofrohet mundësia për planifikime në bazë të të dhënave të freskëta.

Akademia dhe Universitetet luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillim, prandaj Regjistrimi i Popullsisë do të ofroj të dhëna të plota dhe reprezentative që do të shërbejnë për analiza, hulumtime, parashikime, ku

njëkohësisht do të ofrohet mundësia për krahasime me periudhat paraprake, analiza të studentëve, rifreskimi i të dhënave aktuale në librat shkollor.

Ndërmarrjet Publike do të kenë planifikime reale bazuar në të dhëna të freskuara, njëkohësisht do të ofrohet niveli i profesioneve, shkathtësive, edukimit duke filluar nga nivelet më të vogla.

Regjistrimi i Popullsisë ofron të dhëna që janë me interes edhe për **Organizatave Jo-Qeveritare** dhe **Media** ku ato të dhëna janë si: paraqitja e gjendjes aktuale, përfaqësimi gjinor, religjioz, etnik, gjuhësor, edukimi, struktura e popullsisë etj. si dhe karakteristika të ndryshme nga niveli më i ulët (kushtet socio-ekonomike). Kjo do të ndihmon në prezantimin e gjendjes, kritika të bazuar në fakte dhe fuqizim të aktiviteteve.

Hulumtuesit kanë nevojë për të dhëna të plota për shumë fusha hulumtuese. Këto të dhëna do të përdoren për ofrimin e zgjidhjes së disa problemeve, rekomandime për ndërmarrjen e hapave parandalues, sugjerime, rekomandime dhe parashikime.

Institucionet Ndërkombëtare (Eurostat, FMN, BB) kanë nevojë për të dhëna të plota për krahasime dhe analiza. Këto të dhëna do të përdoren për prezantimin e gjendjes aktuale dhe ofrimin e rekomandimeve. Të gjitha palët që janë veçuar, do të njoftohen për pjesëmarrje në konsultime publike.

Tabela e mëposhtme liston palët e interesuara të identifikuara. Gjithashtu, tregon nëse ato janë prekur nga shkaqet, efektet ose të dyja. Përveç kësaj, kolona e fundit në përmbledhje tregon se si ato janë të prekura. Kapitulli 5 jep informacionin se si janë konsultuar këto palë të interesuara.

Tabela 6: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku/qet dhe /ose efekti/efektet me të cilat është lidhur pala	Mënyra me të cilën është e lidhur pala me këtë/këto shkak (shkaqe) ose efekt (efekte)
Institucionet qendrore qeveritare (Ministritë, Agjencinë etj.)	Të dhënat mbi popullsinë dhe çështjet e tjera sociale të disponueshme	Mundësia për ndërmarrjen e hapave /masave adekuate mbështetëse, planifikim, strategji, ligje e analiza
Komunat	Numri i treguesve të shumtë në nivel vendbanimi/komune	Planifikime me bazë të të dhënave të freskëta
Akademia	Të dhënat e plota dhe reprezentative për: analiza, hulumtime, parashikime	Mundësia për krahasimin e të dhënave, analiza e rekomandime
Universitetet	Të dhënat te nevojshme për hulumtime shkencore, analiza duke përfshirë edhe studentët	Rifreskimi i të dhënave aktuale (librave shkollor) analiza, publikime, propozime
Ndërmarrjet publike	Ofrimi i nivelit të profesioneve, shkathtësive, edukimit duke filluar nga nivelet më të vogla.	Planifikime reale bazuar në të dhënat e freskuara
OJQ	Paraqitja e gjendjes aktuale, përfaqësimi gjinor, religjioz, etnik, gjuhësor, edukimi, struktura e popullsisë etj.	Propozime, kritika bazuar në fakte

Media	Karakteristikat e ndryshme nga niveli më i ulët (kushtet socio-ekonomike)	Prezantimi i gjendjes, kritika në nivel qendror, lokal fuqizim të aktiviteteve
Hulumtuesit	Të dhëna të plota për shumë fusha hulumtuese	Zgjidhja e disa problemeve, rekomandime për ndërmarrje e hapave preventiv, sugjerime, rekomandime e parashikime
Institucionet Ndërkombëtare (Eurostat, FMN, BB etj.)	Të dhëna të plota për shumë fusha hulumtuese në një kohë të vetme	Mundësia e vlerësimit të të dhënave të mëparshme, analiza, krahasime, vlerësime dhe parashikime

Kapitulli 2: Objektivat

Objektivat kryesore me të cilat lidhet Koncept Dokumenti i Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, 2021 janë:

- Programi i Qeverisë 2017-2021 respektivisht Zyra e Kryeministrit/Objektivi 8,
- Plani Strategjik i Agjencisë të Statistikave (2018-2022) respektivisht Objektivi specifik.

Këto janë dy objektivat relevante të cilat dalin nga dy dokumente strategjike aktuale/në fuqi dhe që shërbejnë për ti përcaktuar objektivat në lidhje me hartimin e Koncept Dokumentit për Regjistrimin e Popullsisë.

Tabela 7: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Objektivi strategjik/Objektivi specifik	Koncept Dokumenti
Objektivi Specifik: Ofrimi i të dhënave për institucionet publike e private përfshirë ato ndërkombëtare; Përmirësimi i Cilësisë së Informacioneve Statistikore dhe në përgjithësi Sistemit Statistikor, Korniza e re e mostrave si dhe Hartimi i Regjistrimit të Popullsisë.	Programi i Qeverisë 2017-2021, Zyra e Kryeministrit, Objektivi 8
Kosova do të jete pjesë e raundit global për regjistrime.	Konferenca Evropiane e Statisticienëve: Rekomandimet për Regjistrimin e Popullsisë dhe Ekonomive Familjare, 2020
Objektivi Specifik: Të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë për shumë indikatorë do të jenë emëruar i vetëm derisa për shumë te tjerë do të jenë numëruar i përbashkët. a. Rritje e efikasitetit e kapaciteteve të vetë institucionit (ASK) dhe tërë sistemit statistikor; b. Rritja e numrit dhe përmirësimi i cilësisë së prodhimeve statistikore; c. Rritja e nivelit të përputhshmërisë me standardet e BE-së; d. Sigurimi i fondeve shtesë, stabilë, nga donatorët bashkëpunues ndërkombëtare për projekte të reja; e. Tërheqja e më shumë fondeve përmes bashkëpunimit me partnerë të ndryshëm.	Plani Strategjik i Agjencisë së Statistikave (2018-2022)

Kapitulli 3: Opsionet

3.1: Opsioni asnjë ndryshim

Ndryshimet e mëdha që ndodhin brenda një periudhe prej 10 viteve si në aspektin e strukturës së Popullsisë (mosha e gjinia) përfshirë edhe aspektin natyror të rritjes/zvogëlimit të Popullsisë dhe migracionin është e pamundur që të dihen dhe të përcillen pa një freskim të të dhënave gjithëpërfshirëse që i mundëson vetëm Regjistrimi i ri i Popullsisë. Nxjerrja e indikatorëve të rëndësishëm në nivele më të vogla organizative si: struktura e popullsisë, edukimi, punësimi, jetëgjatësia, shkalla e fertilitetit, mortalitetit, popullsia e aftë për punë, popullsia që do të hyjë në moshë pune, ajo që do të hyjë në pension dhe të dhënat bazë për parashikime etj. pa një Regjistrim të Popullsisë këto të dhënat do të jenë jo reprezentative. Kualiteti dhe besueshmëria e të dhënave pa një Regjistrim të freskët është thelbësore për paraqitjen e gjendjes reale në fushat socio-ekonomike dhe nuk mund të sigurohet pa një Regjistrim të ri të Popullsisë. Mos regjistrimi nënkupton që Kosova nuk mund të publikojë/dërgoj të dhëna si tek niveli kombëtarë po ashtu edhe te niveli ndërkombëtar për shumë indikatorë si dhe do të ketë ndikim në zhvillimin e përgjithshëm e po ashtu edhe në integritet.

3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore

Ndryshimet ligjore janë bazike dhe të domosdoshme për realizimin e Regjistrimit të Popullsisë siç është cekur më lartë pasi në ligjin aktual (2010) janë sanksionuar shumë aktiviteteve. Njëkohësisht shumë aktivitete do të varen nga amendamenti i ligjit dhe mos hyrja në fuqi e ligjit mund të sjellë pasoja që të mos realizohet Regjistrimi. Në këtë rast, Agjencia e Statistikave të Kosovës do të vazhdojë aktivitet e saj me publikimin e raporteve të ndryshme që të plotësojë boshllëkun me të dhëna administrativ si dhe me anketa por nuk do të jenë të dhëna gjithëpërfshirëse. Publikimi i shumë raporteve/indikatorëve nuk mund të bëhet në nivele me të vogla si në nivel të Vendbanimeve dhe Komunave.

Kosova nuk do të përfshihet në rundin global të Regjistrimeve si dhe nuk do të mund të ofroj/dërgoj të dhëna tek institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Ky opsion nuk do të zgjedh në tërësi problemin e identifikuar në KD dhe do të ketë ndikime negative të prezantuara në pjesën e ndikimeve të opsioneve.

3.3: Opsioni i tretë: Ndryshimi i Ligjit aktual për Regjistrimin e Popullsisë të Ekonomive Familjare dhe të Banesave nr.03/L-237

Realizimi i Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në vitin 2021 do të gjenerojë statistika relevante, të sakta dhe në kohë, si kusht i domosdoshëm për vendimmarrje të rëndësishme dhe efektive në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe në të gjitha sferat e tjera të jetës shoqërore dhe ekonomike. Regjistrimi do të mundësojë, përveç të tjerave, edhe publikimin e të dhënave për nivele më të vogla se 1 km², duke filluar nga vendbanimet, duke krijuar bazën për hartimin e Regjistrimit të Popullsisë dhe regjistrave të tjerë relevantë për vendin.

Në Regjistrimin e Popullsisë 2021 planifikohet që grumbullimi i të dhënave në teren të bëhet përmes metodës IPAK (Intervista Personale e Asistuar me Kompjuter) e njohur në gjuhën angleze si metoda CAPI (Computer Assisted Personal Interview). Kjo metodë ka përparësi sepse rritet saktësia e të dhënave, monitorimi me efektivitet në teren, konfidencialiteti i të dhënave është me i sigurt si dhe nuk ka nevojë të bëhet përpunimi i të dhënave.

Pasi Kosova nuk posedon ndonjë Regjistër të Popullsisë rezidente (administrative) për indikatorët e shumtë statistikor Regjistrimi i Popullsisë përveç si emërues i shumë indikatorëve ai do të jetë edhe numërues i shumë të dhënave. Regjistrimi i Popullsisë është shumë i rëndësishëm pasi që do të ofrojë të dhëna reprezentative dhe në të njëjtën kohë do të ofrojë të dhëna për gjithë territorin e vendit. Kosova do të jetë pjesë globale e Regjistrimit dhe të dhënat do të jenë të krahasueshme me vendet tjera si dhe duke u bazuar në rekomandimet e fundit ndërkombëtare mbi kualitetin e të dhënave statistikore dhe gjithë përfshirja.

Regjistrimi i Popullsisë do të jetë i obliguar për të gjithë qytetaret e Kosovës të cilët në kohën e regjistrimit janë prezent në Kosovë. Të gjithë ata që për ndonjë arsye nuk do të regjistrohen do të ofrohen disa mundësi derisa të gjithë ata që refuzojnë apo japin të dhëna jo të sakta do të ketë ndëshkime sipas ligjit që do të amendamentohet.

Në Ligjin e ri do të përfshihen rekomandimet e fundit ndërkombëtare si:

- Legjislacioni i BE-së për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave 2021 (shënime sqaruese).¹⁶
- Konferenca e Statistikave Evropiane - rekomandime për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave të vitit 2020.¹⁷
- Parimet dhe Rekomandimet për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave.¹⁸

¹⁶ <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3859598/9670557/KS-GQ-18-010-EN-N.pdf/c3df7fcb-f134-4398-94c8-4be0b7ec0494>

¹⁷ https://www.unece.org/fileadmin/DAM/stats/publications/2015/ECECES41_EN.pdf

¹⁸ https://unstats.un.org/unsd/publication/seriesM/Series_M67Rev3en.pdf

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Opsioni 1 dhe 2 të shqyrtuar nga Grupi Punues nuk adresojnë nevojën për të pasur të dhëna gjithëpërfshirëse, reprezentative, të besueshme dhe në kohë.

Opsioni i 3-të i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit Nr. 03/L-237 për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe Banesave, i rekomanduar nga Grupi Punues, pritet të ketë ndikimet e identikuara në Tabelën 8 që paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumentit. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësishëm të ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës.

Tabela 8: Ndikimet më të rëndësishme të identikuara

Kategoritë e ndikimeve	Ndikimet përkatëse të identikuara
Ndikimet ekonomike	Regjistrimi do të ofrojë të dhëna të sakta, në kohë, të qasshme, të interpretueshme dhe koherente, të cilat do të përdoren për vendimmarrje, planifikime adekuate, formulim të politikave dhe programeve me kosto reale.
Ndikimet shoqërore	Karakteristikat e shtrirjes gjeografike të popullsisë, struktura e popullsisë, arsimi, migrimi, çështjet sociale, ekonomike, kushtet jetesës banesat etj. do të ndikojnë në ofrimin e një pasqyre për tërë shoqërinë.
Ndikimet mjedisore	Shpërndarja hapësinore e objekteve të banimit, ekonomive familjare dhe popullsisë, dendësia dhe karakteristikat tjera janë informacion bazike për ndërmarrjen e aktiviteteve të nevojshme në fushën mjedisore.
Ndikimet në të drejtat themelore	Regjistrimi i popullsisë ofron të dhëna zyrtare mbi kushtet socio-ekonomike të grupeve të caktuara përfshirë punësimin, përfaqësimin, fushat sociale etj.
Ndikimi gjinor	Regjistrimi i ri i Popullsisë, do të krijojë një bazë të shëndoshë për të përcjellë realizimin e barazisë gjinore nga institucionet relevante në nivel kombëtar dhe lokal si ato qeveritare ashtu edhe nga ato joqeveritare.
Ndikimet e barazisë sociale	Indikatorë të shumtë të cilët masin pabarazinë në të ardhura dhe në dimensionet tjera si: kushtet materiale të jetesës, punësimin, edukimin, etj. paraqesin bazën për orientimin e ri të politikave sociale.
Ndikimet tek të rinjtë	Numri, gjinia, kushtet e jetesës, niveli i edukimit, statusi i punësimin, të ardhurat etj. janë bazë për orientimin e politikave për të rinjtë.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Regjistrimi nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në ngarkesën administrative por si emërues për analiza dhe vlerësime është më se i nevojshëm.
Ndikimi i NMV-ve	Përmes rezultateve të regjistrimit, bizneset kuptojnë se sa njerëz jetojnë në një zonë të caktuar, si jetojnë ata, moshën e tyre, gjininë të ardhurat, nivelin e edukimit, shkallën e papunësisë, profesionet etj.

4.1 Ndikimet ekonomike

Regjistrimi i ri i Popullsisë , Ekonomive Familjare dhe Banesave, do të ofrojë të dhëna relevante, të sakta, në kohë, të qasshme, të interpretueshme dhe koherente, të cilat do të përdoren **për vendimmarrje, planifikime adekuate, formulim të politikave dhe programeve me kosto reale.**

Një numër i saktë i popullsisë , është thelbësor për llogaritjen e njërës prej treguesve më të rëndësishëm për matjen e zhvillimit ekonomik siç është BPV (Bruto Produkti Vendor) për kokë banori përmes të cilit mund të monitorohet zhvillimi ekonomik i Kosovës. Sistemi i Llogarive Kombëtare në Agjencinë e Statistikave të Kosovës përshkruan në terma sasior zhvillimin ekonomik të Kosovës për periudha të kaluara, në përgjithësi përdorë gamë të gjerë të të dhënave zyrtare statistikore si bazë. Statistikat Ekonomike zakonisht kanë një përdorim shumë më të gjerë, mirëpo edhe Statistikat e Popullsisë luajnë një rol shumë të rëndësishëm gjithashtu.

Llogaritë Kombëtare aplikojnë disa përkufizime specifike, për shembull termin "popullsi". Sipas konceptit ndërkombëtar të Llogarive Kombëtare, popullsia përbëhet nga të gjithë personat - qytetarë ose të huaj - që banojnë në territorin ekonomik të një vendi, në këtë rast Kosovës. Njerëzit konsiderohen rezidentë në vend nëse kanë pasur një qëndrim të përhershëm në Kosovë për të paktën një vit. Kjo përfshin njerëzit të cilët banojnë në vend, por përkohësisht qëndrojnë jashtë vendit, p.sh për një periudhë prej më pak se një vit. Nuk përfshihen njerëzit që qëndrojnë përkohësisht në vend, si p.sh. jorezidentët që punojnë në vend apo turistët dhe studentët e huaj. Stoku i popullsisë i përcaktuar në këtë mënyrë tregohet në Llogaritë Kombëtare në baza vjetore dhe tremujore me ç 'rast mund të llogariten vlerat e sakta të referencës "për banor" ose "për kokë banori".

Mesataret tremujore dhe vjetore të Popullsisë në Llogaritë Kombëtare bazohen në përditësime të vazhdueshme të popullsisë në Kosovë. Rrjedhimisht, rregullimi i shifrave të popullsisë sipas të dhënave aktuale të dala nga një Regjistrimi i Popullsisë ka një ndikim të rëndësishëm në Llogaritë Kombëtare mesatare tremujore dhe vjetore.

Kjo vlen veçanërisht për BPV-në për frymë, e cila është një nga treguesit më të rëndësishëm dhe shpesh përdoret drejtpërdrejtë për krahasime ndërkombëtare të performancës ekonomike. Një BPV për kokë banori i besueshëm është gjithashtu e një rëndësie të veçantë për hartimin e treguesve të tjerë si Indeksi i Zhvillimit Njerëzor i UNDP-së, Indeksi i Varfërisë Multidimensionale, Indeksi i Zhvillimit Gjinor etj., si pjesë e diskutimit ndërkombëtar për matjen e mirëqenies dhe zhvillimit njerëzor si dhe matjen e Varfërisë shumëdimensionale.

4.2 Ndikimet shoqërore

Regjistrimi i Popullsisë do të prodhojë të dhëna *gjithëpërfshirëse*, për karakteristikat gjeografike, demografike, ekonomike, të arsimit, të migrimit, të kulturës, të përkatësisë etnike, të ekonomive familjare dhe banesave si dhe shumë të dhëna të tjera, të cilat të kombinuara në mes vete do të mundësojnë vlerësimin e situatës socio-ekonomike në nivel vendi si dhe në nivel të personave dhe familjeve. Këto të dhëna janë thelbësore për të ndihmuar formulimin dhe planifikimin e një game të gjerë politikash *ekonomike dhe sociale, programe lidhur me krijimin e punësimit, reduktimin e varfërisë, balancimin e*

punës dhe të jetës, arsimin dhe aftësimin profesional, ofrimin e sigurimeve shoqërore dhe përfitimeve të tjera sociale, barazinë gjinore, përfshirjen sociale, pjesëmarrjen qytetare, etj.

Statistikat mbi *karakteristikat ekonomike të personave (statusi i fuqisë punëtore, profesioni, dega e ekonomisë që i takon, statusi në punësim, etj.)* janë qenësore për të krijuar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të strukturës ekonomike të vendit, si dhe format/llojet e punës, pjesëmarrjen në tregun e punës, shkallën e nën përdorimit të punës së popullsisë së vendit etj.

Statistikat mbi *karakteristikat demografike të popullsisë si: gjinia, mosha dhe statusi martesor*, janë variabla kyçe dhe fundamentale në klasifikimin dhe raportimin e informatave të tjera të dalura nga Regjistrimi, të cilat do të ndihmojnë që të kuptohen drejtë çështjet e ndryshme socio-ekonomike dhe demografike. Disagregimi i të dhënave sipas gjinisë (meshkuj dhe femra), është kërkesë fundamentale për statistika gjinore. Shumica e karakteristikave socio-ekonomike dhe demografike që do të mblidhen nga Regjistrimi i Popullsisë, si arsimi, fuqia punëtore, statusi martesor, migrimi, paaftësia e individëve dhe kushtet e jetesës, në përgjithësi dallojnë sipas gjinisë. Gjinia, së bashku me moshën, janë informacionet më tipike dhe më të rëndësishme demografike të mbledhura nga Regjistrimi, dhe ndër-klasifikimi i këtyre të dhënave me karakteristika të tjera, përbën bazën e shumicës së analizave të shoqërisë dhe karakteristikat demografike të Popullsisë, pasi që ato sigurojnë kontekstin në të cilin vendosen të gjitha informatat e tjera.

Korniza e objektivave dhe indikatorëve global për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe synimet e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, përfshin 17 Objektivat me rreth 232 indikatorë për të cilët është arritur marrëveshje gjithëpërfshirëse, në nivel ndërkombëtar.

Indikatorët e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm duhet të disagregohen, sipas rastit, sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit të migracionit, statusit të personave me *aftësi të kufizuar* dhe vendndodhjes gjeografike ose karakteristikave të tjera, në përputhje me Parimet Themelore të Statistikave Zyrtare.

Pa një Regjistrim gjithëpërfshirës të Popullsisë, ASK dhe ofruesit e tjerë të statistikave zyrtare, nuk do të mund të prodhojnë këta indikatorë që janë të rëndësishëm për të parë dhe monitoruar arritjen dhe progresin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, ka parashikuar që të monitorohen pothuajse 40 tregues, për të cilët do të raportohet si pjesë e një 'Raporti të OZHQ-ve' në të ardhmen. Një rezolutë për OZHQ-të është miratuar njëzëri më 25 Janar 2018 nga Kuvendi i Kosovës. Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe partnerët e tjerë, me mbështetjen e Ekipit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, do të finalizojnë një kornizë treguesish për të mbështetur grumbullimin e të dhënave të vlefshme që mund të përdoren për matjen e progresit dhe raportimin. Një pjesë konsiderueshme e të dhënave që mundësojnë llogaritjen e treguesve nuk do të mund të realizohen *pa një Regjistrim të ri të Popullsisë.*

4.3 Ndikimet mjedisore

Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave do të jap informacione edhe mbi madhësinë, përbërjen dhe karakteristikat e popullsisë, shpërndarja hapësinore e Popullsisë, profesioni, arsimi, gjinia, përbërja e amvisnive dhe mjedisi. Ndër të tjera të dhënat e Regjistrimit të vitit 2021 do të jenë gjithashtu burimi kryesor për azhurnimet e Vlerësimeve dhe Projeksioneve aktuale të Popullsisë.

Shumica e informacioneve të marra nga Regjistrimi i Popullsisë mund të jenë të dobishme për analiza të ndryshimeve të mjedisit dhe klimës. Të dhënat mbi karakteristikat e Popullsisë (gjinia, mosha, struktura e amvisnive, etj.) mund të përdoren për të përcaktuar modelin dhe nivelin e emetimeve të gazrave si dhe kushtet dhe pasuritë e një popullsie që mund të jenë të dobishme për përshtatjen ndaj ndryshimeve mjedisore dhe klimatike.

Parimet dhe Rekomandimet për Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave i Kombeve të Bashkuara, në lidhje me rëndësinë dhe përdorimin e të dhënave të Regjistrimit për mjedis konkludojnë: “*Regjistrimet e Popullsisë dhe Banesave ofrojnë një mjet të fuqishëm për vlerësimin e ndikimit të Popullsisë në mjedis, për shembull, për pellgjet e drenazhimit dhe për sistemet e menaxhimit të burimeve ujore. Njësitë hapësinore për një studim të tillë mund të kombinojnë një grup të zonave lokale administrative. Në këtë situatë disponueshmëria e bazës së të dhënave nga Regjistrimi së bashku me harta është me rëndësi të madhe*”.¹⁹

Lidhja e të dhënave themelore të Regjistrimit, siç është madhësia e popullsisë me zonat gjeografike, lejon llogaritjen e **Dendësisë së Popullsisë**, një tregues klasik për studimin mjedisor, veçanërisht në zonat urbane. Gjithashtu, ky tregues mundëson karakterizimin e vendbanimeve urbane: lagjet e varfra, shtrirjen, përqendrimin dhe shpërndarjen e popullsisë. Për politikatat e përshtatjes, ky tregues është akoma më i përshtatshëm kur kombinohet me variabla të tillë si lloji dhe cilësia e banimit, burimi i ujit, energjia, mënyra e hedhjes së mbeturinave, mënyra e përdorimit dhe mbajtja e tokës. Gjithashtu, ky tregues ndihmon në përcaktimin e qëndrueshmërisë së përdorimit të burimeve në vende të veçanta dhe për të nxjerrë në pah dobësitë sociale dhe mjedisore. Në studimet rreth urbanizimit, treguesi i dendësisë së popullsisë është një nga treguesit më të rëndësishmit dhe më të përdorur.

Për monitorimin e arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), të cilat janë të lidhura me ruajtjen e ambientit siç është Objektivi 6, 7 dhe 11, duhet të përdoren tregues të ndryshëm të cilët mund të llogariten vetëm përmes të dhënave të dala nga Regjistrimi i ri i Popullsisë në vitin 2021.

4.4 Ndikimet në të drejtat themelore

Të drejtat themelore të njeriut janë të mbrojtura në mënyrë të qëndrueshme në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila përmban dispozita të qarta për sigurimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Promovimi dhe zbatimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve të Kosovës është i rregulluar me akte të ndryshme legjislative civile dhe penale, duke përfshirë pakon e *legjislacionit të të drejtave të njeriut* (p.sh. Ligji kundër Diskriminimit, Ligji për Avokatin e Popullit dhe Ligji për Barazi Gjinore), që ka hyrë në fuqi në Korrik të vitit 2015.

¹⁹ United Nations, Department of Economic and Social Affairs Statistics Division (2017), *Principles and Recommendations for Population and Housing Censuses, Revision 3*, fq. 129, Paragrafi 3.264

Realizimi i të drejtave themelore të njeriut është i lidhur ngushtë me disponueshmërinë e Statistikave Zyrtare të cilat luajnë një rol kritik në mbështetjen e politikave të bazuara në evidencë dhe në matjen e të drejtave civile, ekonomike, politike dhe sociale.

Në dekadën e fundit, nga mekanizmat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, shtetet dhe shoqëria civile, është rritur kërkesa për informata statistikore të cilat burojnë nga fusha e të drejtave themelore të njeriut. Përpjekjet në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar drejt realizimit të të drejtave të njeriut gjithnjë e më shumë po përdorin statistika të disagreguara, indikatorë, target dhe pika referimi për të mundësuar matjen dhe implementimin e normave dhe principeve të të drejtave të njeriut.

Të dhënat dhe statistikat e besueshme ofrojnë mjete të fuqishme për përkrahje të fokusuar për identifikimin e zbrazëtirave në realizimin e të drejtave të njeriut dhe krijimin e kulturës së përgjegjësive dhe transparencës. Rritja e vazhdueshme e kërkesës për statistika në fushën e të drejtave themelore përkon me shfrytëzimin e gjerë të indikatorëve statistikor në fushën e zhvillimit siç është e ilustruar në Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit, e tani në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të përfshira në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Agjenda e vitit 2030, synon të luftojë pabarazitë dhe diskriminimin dhe "të mos lë askënd mbrapa", ku përmban një angazhim të fortë ndaj ndarjes (disagregimit) së të dhënave: Agjenda e vitit 2030 riafirmon përgjegjësinë e të gjitha shteteve për të "Respektuar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut, pa dallim të çfarëdolloj race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, mendimesh politike ose mendime të tjera, origjinë kombëtare dhe sociale, pronë, lindje, paaftësi ose gjendje tjetër"(paragrafi. 19). SDG-të përfshijnë dy qëllime të dedikuara për luftën kundër pabarazisë dhe diskriminimit (Qëllimi 5 për arritjen e barazisë gjinore dhe qëllimi 10 për reduktimin e pabarazive brenda dhe ndërmjet Shteteve). Qëllimet dhe synimet synojnë "të mos lënë askënd mbrapa " (paragrafi. 4). Agjenda kërkon që proceset e ndjekjes dhe shqyrtimit të SDG-ve të bazohen në evidencë dhe të dhëna të zbërthyer (disagreguara) sipas "*të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, përkatësisë etnike, statusit të migracionit, aftësisë së kufizuar, vendndodhjes gjeografike dhe karakteristikave të tjera relevante në kontekste Kombëtare*"(paragrafi. 17.18 dhe 74).

Regjistrimi i Popullsisë është burimi kyç për prodhimin e statistikave socio-ekonomike të disagreguara dhe për gjenerimin e mostrave për anketa statistikore përmes të cilave nxirren të dhëna të rëndësishme që përdoren për përpilimin e treguesve përmes të cilëve mund të bëhet vlerësimi dhe monitorimi i realizimit të të drejtave të njeriut. Të dhënat e mbledhura nga Regjistrimi i Popullsisë mund të disagregohen sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit të migracionit, statusit të personave me *aftësi të kufizuar* dhe vendndodhjes gjeografike ose karakteristikave të tjera. Disagregimi i të dhënave ndihmon *dizajnimin, përshtatjen, implementimin dhe monitorimin e masave për të përmirësuar të drejtat themelore njerëzore* dhe kontribuojnë në zbulimin e problemeve në lidhje me të drejtat themelore siç është diskriminimi direkt dhe indirekt.

4.5 Ndikimi gjinor

Vlerësimi i ndikimit gjinor, si një instrument dhe proces, ua mundëson aktorëve të përfshirë të fitojnë një kuptim të thelluar të problemit në shqyrtim, të hartojnë politika dhe ligje që promovojnë shpërndarjen e njëjtë dhe mundësi të barabarta, dhe mbeten një hap i rëndësishëm në sigurimin e përputhshmërisë ligjore për realizimin e barazisë gjinore në jetën reale. Gjatë VNGJ (Vlerësimit të Ndikimit Gjinor), elementet kyçe **janë të dhënat në baza gjinore**. Ligji për Barazi Gjinore kërkon që të gjitha institucionet të grumbullojnë, përpunojnë dhe publikisht të shpërndajnë të dhëna në baza gjinore.

Në këtë drejtim, të dhënat e dala nga Regjistrimi i ri i Popullsisë do të jenë të një rëndësie të jashtëzakonshme për të bërë vlerësimin gjinor si dhe për të krijuar një kornizë të re të mostrës e cila do të mundësonte që anketat e realizuara nga ASK dhe institucionet e tjera qeveritare dhe jo qeveritare që merren me çështje gjinore të nxjerrin të dhëna të përditësuara në këtë drejtim dhe të mundësojnë vazhdimin e publikimeve për çështje gjinore. “Gratë dhe Burrat në Kosovë” është një botim i cili publikohet çdo dy vite nga Agjencia e Statistikave të Kosovës që ofron të dhëna statistikore mbi baza gjinore, gjithashtu edhe Qeveria e Kosovës publikon Profilin Gjinor të Kosovës, përmes të cilit prezantohen analiza mbi dallimet mes burrave dhe grave dhe rolet që u janë caktuar sipas gjinive: në pozicionet e tyre socio-ekonomike, nevojat, pjesëmarrjen, qasjen në burime, kontrollin e aseteve, pushtetin në vendimmarrje, liritë individuale dhe kushtet e të drejtave të njeriut. Publikimi i vazhdueshëm i tyre me të dhëna të përditësuara nga Regjistrimi i ri i Popullsisë, do të krijojë një bazë të shëndoshë për të përcjellë realizimin e barazisë gjinore nga institucionet relevante në nivel kombëtar dhe lokal si ato qeveritare ashtu edhe nga ato joqeveritare.

Regjistrimi i ri i Popullsisë, do të siguroj indikatorë themelorë të zhvillimit të nivelit kombëtar, për shembull mbi fertilitetin dhe shpërndarjen hapësinore të burrave dhe grave. Për treguesit më kompleks, të dhënat e Regjistrimit shpesh shërbejnë si emërues. Për shembull, ato mund të ndihmojnë në zbulimin e pabarazive gjinore në punësim, në shkrim-lexim dhe në moshën e martesës. Kur përdoren përkufizimet dhe klasifikimet ndërkombëtare, treguesit që rrjedhin nga regjistrimet janë të krahasueshme mes vendeve.

Treguesit e tillë pastaj mund të përdoren për të krahasuar progresin në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Në këtë drejtim të dhënat e dala nga regjistrimi i ri do të mundësojnë që të llogariten shumë indikatorë përmes të cilëve do të vlerësohet realizimi i OZHQ, e sidomos realizimi i Objektivit të Pestë: Arritja e Barazisë Gjinore dhe Fuqizimi i të gjitha grave dhe burrave.

Në nivel ndërkombëtar, gjerësisht janë duke u përdorur dy indekse që lidhen me çështje gjinore si:

- *Indeksi i Pabarazisë Gjinore (IPGJ), dhe*
- *Indeksi i Zhvillimit Gjinor (IZHGJ),*

Këta tregues raportohen në baza vjetore nga UNDP përmes Raportit të Zhvillimit Njerëzor (për më shumë se 160 vende), si njëri prej publikimeve më të rëndësishme për zhvillim njerëzor. Deri më tani, në Kosovë nuk kemi të llogaritur asnjërin nga këta tregues. Regjistrimi i ri i Popullsisë do të sigurojë të dhëna relevante

në këtë drejtim, dhe institucionet përgjegjëse do të llogarisin këta tregues, në mënyrë që edhe Kosova të jetë pjesë e shteteve të tjera në kuptimin e raportimit të Barazisë Gjinore.

4.6 Ndikimet tek të rinjtë

Brezat e sotëm të adoleshentëve dhe të rinjve paraqesin një forcë të madhe për ndryshime sociale, ekonomike dhe demografike, duke kontribuar në një forcë konkurruese të punës, rritje të qëndrueshme ekonomike, përmirësim të qeverisjes dhe shoqëri civile më aktive. Realizimi i të drejtave të tyre dhe investimi në zhvillimin e tyre është një mënyrë efektive dhe efikase për të mbështetur vendin në përpjekjet e tij për të adresuar sfidat e reja, për zhvillimin dhe zbatimin e politikave rinore, si dhe për të përsheptuar përparimin drejt Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Të dhënat dhe statistikat sasiore dhe cilësore, njohuritë shkencore dhe informacioni praktik janë të gjitha të nevojshme për hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave efektive të të rinjve. Këto të dhëna thellojnë të kuptuarit e situatës aktuale të të rinjve dhe shërbejnë për të udhëhequr zhvillimin e strategjive dhe politikave të përshtatshme dhe të suksesshme të të rinjve të bazuara në realitet. Të dhënat e Regjistrimit të ri të Popullsisë do të sigurojnë statistika të sakta, në kohë dhe relevante për grup-moshën e të rinjve 15-24 vjet në nivel vendi dhe në nivel komune e edhe për njësi më të vogla gjeografike. Këto të dhëna të ndara sipas gjinisë, statusit ekonomik, nivelit të edukimit, pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës etj, do të jenë shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për Hartimin e Strategjisë së Re Kosovare për Rininë si dhe Planin e Ri të Veprimit për Rininë²⁰, përmes të cilave do të adresohen sfidat e të rinjve në Kosovë me qëllim të përmirësimit të situatës së të tyre.

4.7 Ndikimet në barazinë sociale

Të dhënat e dala nga Regjistrimi i Popullsisë do të jenë të një rëndësie të jashtëzakonshme, sepse përmes tyre do të mund të llogariten dhe vlerësohen indikatorë të shumtë të cilët masin pabarazinë në të ardhura dhe në dimensionet e mëposhtme jetësore: kushtet materiale të jetesës; aktivitetet produktive; shëndetin; edukimin; kohën e lirë; ndërveprimet shoqërore; stabilitetin ekonomik; sigurinë fizike; mjetet e qeverisjes; të drejtat themelore dhe mjedisin jetësor, etj.

Pabarazia dhe rreziqet e varfërisë janë të prekura nga një sërë faktorësh përfshirë rritjen ekonomike, globalizimin, ndryshimin teknologjik, tregjet e punës, mekanizmat e mbrojtjes sociale dhe demografinë.

Derisa pabarazia në shpërndarjen e të ardhurave është kryesisht e nxitur nga ndryshimet në shpërndarjen e pagave, duhet të merren parasysh edhe disa variabla demografike të cilat kanë treguar ndikim në pabarazinë e të ardhurave si: *struktura e moshës, struktura e familjes, përbërja etnike e popullsisë dhe nivelet e arsimit të kryefamiljarit*. Këto të dhëna mund të sigurohen nga një Regjistrim i ri i Popullsisë-

²⁰ *Strategjia e fundit për Rininë është: Strategjia Kosovare për Rininë 2013 - 2017 dhe Plani i Veprimit 2013 - 2015 (SKPVR)*

4.8 Ndikimi te NMV-të

Të dhënat e Regjistrimit janë një pjesë thelbësore e biznesit. Edhe pse të dhënat e Regjistrimit nuk mbledhen për përdorim biznesi, bizneset do të kenë qasje për popullsinë me karakteristikat tjera: moshë, gjinia, edukimi etj. që do të kenë vlerën e rëndësishme në planifikimet e bizneseve të tyre.

Për bizneset, shitjet e të cilëve varen nga konsumatorët individualë, të dhënat e Regjistrimit janë shumë të rëndësishme. Përmes rezultateve të Regjistrimit, bizneset kuptojnë se sa njerëz jetojnë në një zonë të caktuar dhe si jetojnë ata, moshën e tyre, të ardhurat, nivelin e edukimit, format e punësimit dhe profesionet. Gjithashtu, Regjistrimi përshkruan llojet e shtëpive që njerëzit kanë, në aspektin e moshës së shtëpisë, numrin e dhomave, vlerën, nëse ka kuzhinë të plotë dhe pajisje, disponueshmërinë e telefonave dhe makinave dhe llojin e lëndës djegëse të ngrohjes të përdorur në shtëpi. Kjo mund të ndihmojë bizneset që të marrin vendime të rëndësishme se ku mund të vendosin biznesin dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre.

Një përparësi e madhe e statistikave të Regjistrimit është se ato janë në dispozicion deri në zona shumë të vogla gjeografike dhe ato zakonisht janë falas.

4.9 Ndikimet buxhetore

Pjesa dërmuese e buxhetit do të shpenzohet në angazhimin e stafit si Regjistruesit, mbikëqyrësit, mbështetësit, monitoruesit, anëtarët e Komisioneve Komunale si dhe stafi profesional nga institucionet relevante që do të shpenzohen rreth 75% të buxhetit. Numri i përllogaritur i regjistruesve dhe mbikëqyrëseve aktiv do të jetë rreth 3.200 derisa ata rezervë do të përfshijë një numër prej rreth 3.500. Po ashtu një shume e caktuar (rreth 4%) do të shpenzohet për fushatën komunikuese, rreth 12% do të shpenzohet për pajisje kryesisht tabletë, projektor, server, laptop dhe kompjuter ndërsa sa i përket shpenzimeve tjera do të jenë rreth 9%.

4.10 Sfidat ne hartimin e Koncept Dokumentit

Gjatë hartimit të Koncept Dokumentit është dashur të bëhet shpjegim më detal i aktivitetëve, metodologjisë dhe terminologjisë me qëllim të qasjes më të mirë të projektit.

Ndryshimet që janë bërë për hartimin e Koncept Dokumentëve kishin ndikim duke marrur kohë derisa është harmonizuar me propozimet standarde.

Përfaqësuesit e disa Institucioneve kishin kërkuar që të bëhet një elaborim detal i ndikimit të Regjistrimit të Popullsisë në fushat që ata mbulonin.

Përkundër njoftimit për pjesëmarrje në takime apo për dhënien e komenteve numri institucioneve, organizatave, individëve e hulumtueseve ishte me pak se që ishte pritur.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Agjencia e Statistikave do të përgatitë fushatën e komunikimit dhe konsultimeve me: popullsinë e gjerë, grupet e interesit, institucionet, akademinë, universitetet, shoqërinë civile, OJQ-të, komunitet fetare, religjioze, etnike, shoqatat, grupet specifike (personat me aftësi të kufizuar, shtëpitë e të moshuarve), përmes takimeve, debateve, punëtorive, mediave, shkrimeve dhe reklamave të ndryshme.

Më poshtë në figurën 8 janë pasqyruar aktivitetet që janë kryer.

Tabela 9: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një Koncept Dokument

Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikim i/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjitha palët e interesuara	Të gjitha palët e interesuara	Takim publik	Ftesa, e-mail, web faqes, telefon	Pjesa I - e muajit Maj 2019		Hazbije Qeriqi
Konsultimi publik me shkrim (pas përgatitjes së draftit të parë të Koncept Dokumentit)	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik	Ftesa, e-mail, takime	Pjesa I - e muajit Maj 2019		Hazbije Qeriqi
Konsultim i Fokusuar	Komuniteti Akademik, Universitetet, Institutet Hulumtuese, OJQ	Fokus Grupe	Ftesa, e-mail, takime	Pjesa II e muajit maj-shtator 2019		Hazbije Qeriqi
	ZKM / Ministrinë, Agjencitë, Institutet, Komunitat, Organizata Ndërkombëtare etj.	Fokus grupe	Ftesa, e-mail, takime	Pjesa II e muajit shtator-dhjetor 2019		Hazbije Qeriqi
	Komuniteti, religjioze, etnik	Fokus grupe	Ftesa, e-mail, takime	Pjesa II e muajit shtator-dhjetor 2019		Hazbije Qeriqi

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Opsioni asnjë ndryshim - mos realizimi i Regjistrimit të Popullsisë do të sfidonte të gjitha institucionet dhe do të ishte një stagnim i tërë sistemit statistikor me pasoja në mos besueshmëri në të dhëna statistikore. Kjo do të afektonte edhe planet, strategjitë dhe ligjet e ndryshme. Mos realizimi i Regjistrimit të Popullsisë nuk do të ketë edhe kosto financiare.

Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore-do të pamundësonte realizimin e Regjistrimit pasi ka ndryshime të theksuara duke filluar nga; kohëzgjatja në terren, përfshirja e institucioneve, kompetencave, metoda e grumbullimit si dhe rekomandimet ndërkombëtare. Kostoja financiare pa ndryshime ligjore mund të jetë rreth 20-30% e shumës së përgjithshme të projektit duke mos dhënë rezultate reprezentative dhe të besueshme.

Ndryshimin e Ligjit aktual për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave Nr.03/L-237- do të mundësojë realizimin e Regjistrimit dhe ofrimin e të dhënave të freskëta, sakta, gjithë përfshirëse deri në nivelet me të vogla administrative. Kostoja financiare me ndryshimin e ligjit do të jetë rreth 12.2 mil. Euro.

6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Agjencia e Statistikave të Kosovës e parasheh si të domosdoshëm që të amendamentohet Ligji aktual i Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave dhe të miratohet nga Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që të krijohen kushtet normative për të filluar përgatitjet dhe për ta bërë të mundur Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave të Kosovës në vitin 2021.

Tabela 10: Plani i zbatimit për Opsioni 1

Qëllimi i Politikës	<i>Asnjë ndryshim</i>								Shifra e kostos së pritur	
<i>Objektivi strategjik</i>	Posedimi i të dhënave statistikore në nivel vendi									
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës									
Objektivi Specifik 1. Realizimi i Regjistrimit të Popullsisë 2021	Outputi 1.1	Përgatitjet për regjistrim								
		Aktivitete Kryesore	Viti 1 2020	Viti 2 2021	Viti 3 2022	Viti 4 2023	Viti 5 2024	Institucioni /Departamenti përgjegjës		
		Aktiviteti 1.1.1								
		Aktiviteti 1.1.2								

		Aktiviteti 1.1.3							
		Të tjera:							
	Outputi 1.2	Regjistrimi							
		Aktivitete Kryesore	Viti 1 2020	Viti 2 2021	Viti 3 2022	Viti 4 2023	Viti 5 2024	Institucioni /departamenti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.2.1							
Objektivi Specifik 2	Outputi 2.1	Aktiviteti 2.2.1							
	Outputi 2.2	Aktiviteti 2.2.2							
Objektivi Specifik N	Outputi N.1	Tjera							

Tabela 11: Plani i zbatimit për Opsioni 2

Qëllimi i Politikës	Përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit pa ndryshime ligjore							Shifra e kostos së pritur	
Objektivi strategjik	Regjistrimi i popullsisë i nevojshëm								
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Objektivi Specifik 1. Realizimi i Regjistrimit të Popullsisë 2021	Outputi 1.1	Përgatitjet për regjistrim							
		Aktivitete Kryesore	Viti 1 2020	Viti 2 2021	Viti 3 2022	Viti 4 2023	Viti 5 2024	Institucioni /Departamenti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.1.1 Të dhëna të agreguara në nivel komune.	65,000	55,000	120,250	73,000	32,000	ASK	345,250
		Aktiviteti 1.1.2 Grumbullimi i të dhënave administrative për disa indikatorë.	245,000	320,000	20,000			ASK-ARC	585,000

		Aktiviteti 1.1.3 Testimi (anketimi) i të dhënave administrative			160,000	360,000	180,000	ASK, ARC, MSH, MASHT, MI, MAP etj.	700,000
		Të tjera (zhvillimi i aplikacioneve)			80,000	60,000		ASK	140,000
	Outputi 1.2	Regjistrimi							
		Aktivitetet Kryesore	Viti 1 2020	Viti 2 2021	Viti 3 2022	Viti 4 2023	Viti 5 2024	Institucioni /Departamenti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.2.1 Krahasimi dhe monitorimi.			72,000	105,000	42,000	ASK-ARC	
Objektivi Specifik 2	Outputi 2.1	Aktiviteti 2.2.1 Lidhja e të gjitha databazave-testimi.				420,000	35,000	Gjitha Institucionet	455,000
	Outputi 2.2	Aktiviteti 2.2.2 Viti i parë testues					172,000	ASK	172,000
Objektivi Specifik N	Outputi N.1	Tjera (funksionalizimi) të dhënat administrative në shfrytëzim/blerja e serverëve dhe menaxhimi.					320,000	ASK	320,000

Tabela 12: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i Politikës	Ndryshimin e ligjit aktual: Realizimi i Regjistrimit të Popullsisë 2021								Shifra e kostos së pritur
Objektivi strategjik	Regjistrimi i popullsisë të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare								
	Outputi, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës								
Objektivi Specifik 1. Realizimi i Regjistrimit të Popullsisë 2021	Outputi 1.1	Përgatitjet për regjistrim							
		Aktivitetet Kryesore	Viti 1 2020	Viti 2 2021	Viti 3 2022	Viti 4 2023	Viti 5 2024	Institucioni /Departamenti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.1.1 Formimi i grupit punues, koordinues dhe ekzekutiv në ASK	21,600	28,800	14,400	10,800		ASK/ Institucionet tjera	75,600

		Aktiviteti 1.1.2 Stafi kryesor profesional.	185,240	573,640	139,340	32,400		ASK/ Institucionet tjera	930,620
		Aktiviteti 1.1.3 Komisioni Qendror i Regjistrimit.	4,360	6,360	0	0		ASK/ Institucionet tjera	10,720
		Aktiviteti 1.1.4 Stafi Mbështetës (Komisionet Komunale).	0	480,780	0	0		ASK/ Institucionet tjera	480,780
		Aktiviteti 1.1.5 Konferenca, takime, grante (OJQ-ve), udhëtime.	114,800	29,480	7,000	0		ASK/ Institucionet tjera	151,280
		Aktiviteti 1.1.6 Fushat e komunikimit dhe sensibilizimit.	365,800	33,800	0	0		ASK/ Institucionet tjera	399,600
		Të tjera: Përkthime, printime, publikime.	24,700	58,100	30,000	0		ASK/ Institucionet tjera	112,800
		Regjistrimi							
		Aktivitete Kryesore	Viti 1 2020	Viti 2 2021	Viti 3 2022	Viti 4 2023	Viti 5 2024	Institucioni /Departamenti përgjegjës	
	Outputi 1.2	Aktiviteti 1.2.1 Materiale shpenzuese, dokumentimi, shkresa në Ek. familjareje etj.	59,915	0	0	0			59,915
		Aktiviteti 1.2.2 Letër shkrimi dhe materiale tjera të zyrës.	128,700	0	0	0		ASK/ Institucionet tjera	128,700
Objektivi Specifik 2	Outputi 2.1	Aktiviteti 2.1.1 Krijimi i QR te reja Regjistruese /GIS.	332,400	0	0	0		ASK/ Institucionet tjera	332,400
		Aktiviteti 2.1.2 Tele-komunikimi.	600	45,450	600	0		ASK/ Institucionet tjera	46,650

		Aktiviteti 2.1.3 Tavolina ndihmese (Zyra Qendrore dhe në Komuna/staf mbështetës).	265,200	0	0	0		ASK/ Institucionet tjera	265,200
		Aktiviteti 2.1.4 Arivimi, dokumentimi, futja e të dhënave etj.	18,500	28,000	0	0		ASK/ Institucionet tjera	46,500
	Outputi 2.2	Aktiviteti 2.2.1 Pajisje: Tablete, kompjuter, server etj.	1,340,340	70,000	40,000	20,000		ASK	1,470,340
		Aktiviteti 2.2.2 Mirëmbajta dhe riparimi.	12,550	33,050	37,050	0		ASK	82,650
		Aktiviteti 2.2.3 Pilot Anketa.	91,650	0	0	0		ASK/ Institucionet tjera	91,650
		Aktiviteti 2.2.4 Trajnimi & Regjistrimi ne teren.	0	3,858,250	0	0		ASK/ Institucionet tjera	3,858,250
		Aktiviteti 2.2.5 Anketa Post- Regjistruese.	0	163,250	0	0		ASK/ Institucionet tjera	163,250
		Aktiviteti 2.2.5 Kodifikimi & Analizat.	0	56,700	0	0		ASK/ Institucionet tjera	56,700
		Aktiviteti 2.2.5 Publikimi i raporteve.	0	34,680	42,200	0		ASK/ Institucionet tjera	76,880
Objektivi Specifik N	Outputi N.1	Tjera: Ekspertiza ndërkombëtare, monitorimi etj.	88,500	519,749	221,509	218,080		ASK/ Institucionet tjera	1,047,838
	Outputi N.2	Shpenzimet e paparashikuara.	305,486	602,009	53,210	28,128		ASK	988,832

6.2: Tabela e krahasimit me tri opsionet

Opsioni më i mirë, gjithëpërfshirës, i nevojshëm dhe sipas standardeve ndërkombëtare është realizimi i Regjistrimit me ndryshimet ligjore.

Tabela 13: Krahasimi i opsioneve

Mjeti i krahasimit:												
Ndikimet relevante	Opsioni 1: Asnjë ndryshim				Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit				Opsioni 3:			
	Ndikimet relevante pozitive	Efikasiteti i ultë, cilësia e të dhënave jashtë kornizës standarde, të dhëna më pak për shfrytëzuesit dhe më pak të besueshme.				Të dhëna të agreguara por jo në nivele më të vogla administrative dhe pak të dhëna për shumë indikatorë.				Efikasiteti më i lartë, kostoja më e ulët, cilësia më e lartë e të dhënave, mbulueshmëria dhe shpejtësia/në kohë.		
Ndikimet relevante negative	Kosova nuk do të jetë pjesë e komuniteti global të Regjistrimeve, pamundësia e dërgimit të të dhënave në Eurostat, FMN, BB, ILO etj.				Të dhënat nuk do të jenë të krahasueshme për shumë indikatorë në nivelin ndërkombëtarë.				Plotësimi i parametrave matës për Sistemin Statistikore të Kosovës, si instrument i integrimi (Integrimi Evropian, SDG-ve) dhe projekteve tjera nacionale apo regjionale.			
Kostot relevante	1,200,000 Euro (ritjes së hulumtimeve, azhurnimeve, testeve etj.)				Realizimi i Regjistrimit pa ndryshime ligjore do të jetë jo gjithëpërfshirës, jo kualitativ dhe jo i pranueshëm.				Kjo shifër duhet të rrjedh nga përshkrimi i Opsionit dhe Punës së Planifikuar në Planin e Zbatimit të Opsionit.			
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4
	00	00	00	00	310,000	375,000	452,250	1,799,000	3,360,341	6,622,098	585,309	309,408
Përfundimi	0.00				Gjithsej: 2,936,250				Gjithsej: 10,877,155			

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Pa ndryshime ligjore që do ti obligonte qytetarët që të marrin pjesë në Regjistrim si dhe involvimin e Institucioneve tjera Qeveritare e Komunale është vështirë të priten rezultate të kënaqshme. Për shkak të projektit madhor shumë e rëndësishme është ofrimi dhe plotësimi i kushteve (hapësirë pune) e pajisjeve adekuate (serverë, tabletë, kompjuter, laptop etj.). Po ashtu, involvimi i grupeve tjera të interesit është i domosdoshëm. Përfshirja e Qeverisë, komisioneve komunale, shoqërisë civile, universitetit, akademisë etj. është shumë e rëndësishme. Opsioni i tretë, Regjistrimi i plotë dhe përfshirja angazhimi i shumë institucioneve, individëve etj. është i domosdoshëm.

7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Krahasimi i të dhënave paraprake dhe të dhënave administrative do të jenë instrumente të rëndësishme për të monitoruar kualitetin dhe gjithë përfshirjen e tërë popullsisë. ASK-ja planifikon që të realizoi po ashtu një anketë menjëherë pas regjistrimit “Anketa Post-Regjistruese” për të matur/vlerësuar gjithë përfshirjen dhe kualitetin e të dhënave. Po ashtu, pritet që të ketë monitorim ndërkombëtarë për të vlerësuar tërë procesin e Regjistrimit të Popullsisë 2021.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo			
Vendet e punës ²¹	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		X			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?		X			
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?		X			
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		x			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?		X			
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		x			
	A do të krijohen biznese të reja?		X			
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		x			
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		X			
Tregtia	A pritët të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		X			
	A pritët të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		X			
Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		x			

²¹ Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		x			
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		x			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		x			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		x			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		x			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		x			
	A do të ulët çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		x			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		x			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		x			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		x			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?					
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		x			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		x			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?	x				
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës ²²	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?		x			
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?		x			
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?		x			
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?		x			
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?		x			
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		x			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?		x			
	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		x			

²² Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

Përfshirja sociale	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		x			
	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		x			
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		x			
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?		x			
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?		x			
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?		x			
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?		x			
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		x			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?					
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?		x			
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?		x			
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?		x			
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?					
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	x				
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	x				
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		x			

	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		x			
Shëndeti dhe siguria publike ²³	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		x			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		x			
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		x			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		x			
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		x			
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?		x			
	Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		x		
A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?			x			
A ndikon në nivelet e korrupsionit?			x			
A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?			x			
A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?			x			

²³ Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		x			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		x			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		x			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		x			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		x			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		x			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		x			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		x			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		x			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		x			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		x			
	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		x			

	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		x			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të gjeneruara?		x			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		x			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		x			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		x			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		x			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		x			
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		x			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		x			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		x			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		x			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		x			
Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		x			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		x			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	Ndikimi kryesor	A pritët të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?		x			
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?	x				
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?	x				
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?		x			
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?	x				
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?		x			
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	x				
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	x				
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	x				

Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		x			
Të drejtat pronësore	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?		x			
	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?		x			
Trajtimi i barabartë ²⁴	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?		x			
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?		x			
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?		x			
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?		x			
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuar?		x			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?		x			
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të paditurit?		x			
	A ndikohet qasja në drejtësi?		x			

²⁴ Barazia gjinore trajtohet në Vlerësimin e Ndikimit Gjinor

